



**NDËRTOJMË
TË ARDHMEN!**

UNIVERSITETI MESDHETAR | SHQIPËRISË

E ardhmja i përket atyre që investojnë në dije, ne ndërtojmë të ardhmen!

Misioni i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është përgatitja e specialistëve, liderëve të spikatur për sektorin publik, privat dhe jofitimprurës, gjenerimi i ideve që u japin përgjigje dhe zgjidhje sfidave aktuale si dhe perspektivave të zhvillimit të vendit dhe rajonit. Filozofia e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë është ndërtimi i një komuniteti mësimi dhe krijimi në të cilin respektohet, vlerësohet dhe besohet çdo pjesëtar dhe zhvillohen pritshmëri të larta për veten dhe të tjerët, nëpërmjet inspirimit, arritjeve dhe ekselencës.

85%

e studentëve që kanë përfunduar studimet në Universitetin Mesdhetar janë të punësuar në institucione shtetërore, publike dhe private.



Fjala e themeluesit



*Të dashur miq,
Studentë, kolegë, bashkëpunëtorë ndër vite,*

10 vite më parë Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë u themelua me objektivin e qartë për të sjellë një frymë të re në fushën e edukimit universitar dhe kërkimit shkencor. Vizioni ynë ambicioz e vendosi Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë shumë shpejt ndër ato institucione që jo vetëm kishin hapur auditoret e tyre për studentët por edhe si kontribues me vlera të spikatura në zhvillimet ekonomike dhe sociale dhe politike të vendit. Kishte ardhur koha që jo vetëm edukimi por edhe fusha të tjera kanë të bëjnë me rininë dhe me zhvillimin e vendit të mos trajtoheshin më si biznese por si një e drejtë e të gjithëve. Veprimtaria e Universitetit si organizatë jo fitim prurëse megjithë skepticizmin e fillimit ja doli të ishte një model i suksesshëm ku studentët, pedagogët, kërkuesit shkencorë, bizneset dhe institucionet publike të ishin të gjithë bashkëpunëtorë dhe bashkëpërfitues. Sot, duke parë jo me modesti arritjet janë të dukshme. Universiteti filloi me x programe studimi dhe sot funksionon në tre fakultete dhe me 29 programe studimi në fusha që prekin studimet ekonomike, shkencat politike dhe juridike, studimet psikosociale të gjitha të lidhura në një bost të dukshëm të lidhjes midis studimit dhe aksesit real në tregun e punës. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë vjen krenar me konferencat e zhvilluara, me nivelin e lartë të kërkimit shkencor dhe me produktin konkret duke prekur tematika me interes bashkëkohor sic ishte kriza pasojat, sfidat dhe zgjidhjet, punësimin, nevojën për një model të ri ekonomik, arsimin dhe sfidat aktuale në kohë të vështira. Këto produkte jo vetëm për Shqipërinë por duke përfshirë edhe rajonin, pra si sfida jo vetëm shqiptare por edhe rajonale.

Ne sot krenohemi me arritjet e studentëve tanë të cilët kanë krijuar profilin e vet të dukshëm në institucione shtetërore të të gjitha niveleve, në fushën e kërkimeve të thelluara shkencore në Universitete prestigjioze ndërkombëtare dhe si administratorë të suksesshëm biznesesh. Kjo si rezultat i përpjekjeve tona për të siguruar infrastrukturën e duhur, jo vetëm fizike por edhe si inkubator i krijimit të ideve inovatore, (mund të përmendim Panairin e ideve, Kinemanë politike, Projekti i Klinikës Ligjore, analizës së thelluar të problematikavë nëpërmjet forumeve shkencore). Ky është një tharm i mjaftueshëm që i shërben brezave të të diplomuarve për të qenë të sigurtë në hapat që do hedhin në rrugëtimin e tyre profesional. Ne jemi mentorë të përjetshëm të tyre duke u përkujdesur nëpërmjet rrjetit ALUMNI dhe gjithë mbështetjes sonë institucionale.

Jemi krenarë që filozofia jonë e fillimit, ajo e një grupi të ngushtë bashkëpunëtorësh, sot është reflektuar dhe përfaqëuar nga një ekip i zgjeruar kolegësh me të cilët së bashku po konsolidojmë shtyllat e rëndësishme të strategjisë për 10 vitet e ardhshme të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Të gjithë së bashku jemi të vetëdijshëm që Arsimi i lartë nuk mund të vazhdojë të jetë vëzhgues i zhvillimeve sociale ekonomike dhe politike por duhet të jetë pjesë integrale e këtyre zhvillimeve. Ne synojmë që Universiteti Mesdhetar në 10 vitet e ardhshme të vazhdojë të konfirmojë këtë rol të rëndësishëm në një përtneritet të shtuar me aktorët e tjerë socialë për të qenë një pol i progresit aq të nevojshëm për shoqërinë tonë.

Anxhela Anxheli

President Nderi i UMSH

Historiku



Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë kalon me sukses procesin e akreditimit në të gjitha programet e ofruara. Vazhdon të përmirësojë standardet duke u ofruar studentëve një godinë të re me salla të reja leksionesh dhe seminaresh.

2019

2019-Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në 10 –vjetorin e tij, rikonfirmoi edhe njëherë pozicionin e tij si një nga shkollat e larta më elitare në vend. Me një qasje që e diferencon nga të tjerët UMSH dëshmon se ajo që e pret në dekadat e ardhshme është shumë më e madhe dhe në përputhje me vizionin që vendos studentët në qendër.

2018

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë kalon me sukses akreditimin institucional. Vazhdon të rritet numri i studentëve, i stafit pedagogjik dhe i programeve të ofruara.

2017

Hapen programet e reja në ciklin e dyte në fushën e teknologjise së informacionit. Vazhdon rritja e numrit të studentëve dhe të stafit pedagogjik.

2016

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë vazhdon të rrisë numrin e studentëve dhe vazhdon të organizojë konferenca ndërkombëtare, forume shkencore dhe të forcojë bashkëpunimin ndërkombëtar.

2015

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë vazhdon të përsosë standardet dhe tu ofrojë studentëve cilësinë më të lartë të mësim-dhënies në një periudhë sfidash dhe reformash të thella në arsimin universitar.

2014

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë vazhdon të rrisë numrin e studentëve dhe të programeve të studimit.

2013

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë diplomon brezin e parë të studentëve të programeve Bachelor si dhe vazhdon traditën e zhvillimit të konferencave shkencore ndërkombëtare. Kalon me sukses procesin e akreditimit në të gjitha programet e ofruara.

2012

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ju ofron studentëve standardet më të larta në ambiente të reja dhe moderne në godinën e tij të re. UMSH zgjeron bashkëpunimet me Universitete brenda dhe jashtë vendit si dhe bëhet anëtar i rrjeteve të rëndësishme Universitare në rajonin e Mesdheut, Evropës dhe Azisë.

2011

Profili i Universitetit Mesdhetar në fushën e arsimit të lartë konsolidohet duke rritur numrin e studentëve dhe të stafit pedagogjik dhe duke organizuar konferenca shkencore ndërkombëtare të suksesshme.

2010

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë u themelua në vitin 2009 si një organizatë jo fitim prurëse duke pasur si themel të filozofisë së tij promovimin e arsimit të lartë cilësor si një nga shtyllat e progresit social dhe ekonomik të vendit.

2009

Drejtuesit Kryesorë



Akademik Prof. Dr. Anastas Angjeli

Profesor në fushën e ekonomisë dhe të financës, me një kontribut të shquar, veçanërisht në atë të financave publike dhe të reformave strukturore në ekonomi. Prej vitit 1982 e më pas ka kontribuar në profesorat e Fakultetit të Ekonomisë së Universitetit të Tiranës e më tej, pas vitit 1990 me angazhimet e tij në politikë. Deputet i Kuvendit të Shqipërisë për disa mandate që nga 1991 në vazhdim, Ministër i Ekonomisë, Ministër i Financave dhe Ministër i Punës dhe të Çështjeve Sociale. Prof. Dr. Angjeli është themeluesi i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, anëtar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë dhe anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve. Është afirmuar si një nga ekonomistët më të shquar, veçanërisht në aplikimin e reformave të ekonomisë së tregut në Shqipëri. Kontributi i tij i veçantë për reformën buxhetore e fiskale, për zhvillimin e sistemit financiar (bankar dhe jo bankar), për zbatimin e politikave fiskale në dobi të zhvillimit të biznesit dhe të investimeve vendase e të huaja në Shqipëri, për zhvillim-



Prof. Dr. Gudar Beqiraj

Akademik Prof. Dr. Gudar Beqiraj, Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Ka lindur në vitin 1948 në Durrës. Prej vitit 2012 është anëtar i Akademisë Europiane të Shkencave dhe Arteve. Në të njëjtën kohë, mban titullin "akademik" i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë që prej vitit 2003, titullin Profesor dhënë nga Këshilli i Lartë i Atestimit të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë që prej vitit 1994, dhe Doktor prej vitit 1982. Ka një kontribut të vyer shkencor, shoqëror dhe sportiv kombëtar dhe ndërkombëtar. Është botues i disa librave në fushën e informatikës dhe zbatimit të saj në gjeofizikë si edhe i dhjetra artikujve shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit.

in e lirisë ekonomike, për kryerjen e reformave strukturore dhe privatizimin e ekonomisë, për liberalizimin e integrimin e ekonomisë Shqiptare në atë rajonale dhe evropiane, gjatë

STRUKUTRA DREJTUESE E UNIVERSITETIT MESDHEHTAR TË SHQIPËRISË

*Themelues
President Nderi:*
Anastas Angjeli

Rektor:
Gudar Beqiraj

Zëvendës Rektorët:
Greta Angjeli
Nevila Rama
Nikolin Pano

Bordi i Administrimit:
Eros Angjeli Kryetar
Nexhmi Dumani
Nikolin Pano
Illa Kristo
Greta Angjeli
Jona Marashi
Mirela Lika

Administrator:
Ilir Hebovija

Dekan:
Ksenofon Krisafi
Nikolin Pano
Përparim Kabo



Prof. Dr. Nexhmi Dumani, Rektor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë gjatë viteve 2013-2018. Ka lindur në vitin 1945. Prej vitit 2015 mban titullin: Profesor i Asociuar akorduar nga Fakulteti i Ekonomisë Agrare, Universiteti i Bujqësisë, Tiranë, Doktor i shkencave ekonomike prej vitit 1982 si edhe docent prej vitit 1986. Ka një kontribut të vyer shkencor, shoqëror dhe administrativ. Është botues i disa monografive, librave dhe teksteve shkencore

periudhës së tranzicionit është vlerësuar jo vetëm nga opinioni publik vendas por edhe nga institucionet ekonomiko – financiare ndërkombëtare. Prof. Angjeli është autor dhe

në fushën e ekonomisë, agronomisë, organizimit bujqësor, ekonomisë bujqësore etj të botuar brenda dhe jashtë vendit.



bashkautor i shumë artikujve shkencorë, brenda dhe jashtë vendit, i disa librave universitarë dhe monografive.

Doctor Honoris Causa



Z. Felix Unger, President i European Academy of Sciences and Arts dhe personalitet i shquar në fushën e kardiokirurgjisë dhe mjekësisë botërore, i është dhënë titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në krijimin dhe zhvillimin e hapësirës së përbashkët europiane të shkencës dhe ngritjen e drejtimin e institucioneve të rëndësishme në funksion të saj".



Z. Andreas Gross, Kryetar i Grupit Parlamentar Socialist në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, personalitet i shquar i politikës europiane dhe studiues e aktivist në fushën e filozofisë dhe çështjeve të demokracisë, i është dhënë i jepet titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe në mbështetjen dhe zhvillimin e proceseve demokratizuese për ridimensionimin e shoqërive post totalitare në Europë".



Prof. Dr. Aristotel Pano, një nga studiuesit më të spikatur e aktivist në fushën e studimeve ekonomike në Shqipëri, i jepet titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në veprimtarinë shkencore dhe pedagogjike në fushën e financave dhe ekonomisë në Shqipëri dhe rol të spikatur në përhapjen e dijes".



Z. Gianni Pittella, personalitet i shquar i politikës evropiane dhe studiues i mprehtë i çështjeve dhe politikave Euro-Mesdhetare, i është dhënë titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në nxitjen dhe mbështetjen e proceseve integruese Euro-Atlantike të Shqipërisë".



Z. Theodoros Pangalos, personalitet i shquar i politikës greke e asaj europiane dhe studiues e aktivist në fushën e studimeve ekonomike, i është dhënë titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në zhvillimet e proceseve demokratike dhe perspektivën europiane të Greqisë, mbështetjes për Shqipërinë në avancimin e proceseve demokratike dhe perspektivës së saj europiane dhe mbarëvajtjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe të mirëkuptimit ndërmjet dy vendve dhe dy popujve tanë".



Z. Michael D. Granoff, Kryetar i Fondit Amerikano-Shqiptar të Ndërmarrjeve dhe personalitet i shquar i ekonomisë dhe politikës amerikane, i është dhënë titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në drejtimin me sukses të Fondit Amerikano-Shqiptar të Ndërmarrjeve, si iniciativë e Qeverisë amerikane për financimin dhe zhvillimin e sektorit privat në Shqipëri dhe nxitjen e mbështetjen e ekonomisë shqiptare".



Prof. Dr. Uricchio Antonio Felice, Rektor i Universitetit "Aldo Moro" te Barit, studiues në fushën e studimeve të së drejtës dhe financave publike, i jepet titulli "Doctor Honoris Causa" me motivacionin: "Për kontribut të shquar në nxitjen e bashkëpunimit ndëruniversitar për zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit ndërmjet Italisë dhe Shqipërisë dhe ndërtimin e instrumentave të përbashkët në funksion të këtij bashkëpunimi".



NJË RRUGËTIM SUKSESI

10-vjeçar
drejt së nesërmes

10.000
studentët tanë
e dëshmojnë
këtë





ZGJIDH
MESDHETARIN
PËR NJË
EKSPERIENCË
UNIKE NË DIJE

Forumet shkencore

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka krijuar traditën e organizimit të Forumit të Mesdheut, e cila zhvillohet në mjediset e Universitetit Mesdhetar. Ky Forum zhvillohet periodikisht njëherë në tre muaj. Në këtë kontekst janë zhvilluar Forumet me tematikat e mëposhtme:

Forumi Liria ekonomike dhe zhvillimit ekonomik,

Ky Forum u organizua në tetor 2010 dhe u mbështet në analizat dhe vlerësimet e botimit "Transition and Economic Freedom in Albania", të Prof. Dr. Anastas Angjeli. Në Forum morrën pjesë personalitete të shquara të fushës akademike, studiues, dhe studentë.

Forumi Ekonomik Shqipëri-Kosovë: "Rritja e shkëmbimeve ekonomike-tregtare Shqipëri – Kosovë në kushtet aktuale".

Në datën 12 gusht 2011, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe Aleanca Kosovare e Bizneseve organizuan Forumin Ekonomik Shqipëri – Kosovë: "Rritja e shkëmbimeve ekonomike-tregtare Shqipëri – Kosovë në kushtet aktuale". Ky aktivitet u organizua në Amfiteatrin "Adam Smith" të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Në këtë Forum të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të të dy vendeve, morrën pjesë anëtarë dhe përfaqësues të qeverive të Shqipërisë dhe Kosovës. Përveç tyre, në Forum morrën

pjesë personalitete të shquara të fushës akademike, studiues, dhe studentë.

Forumi "Kolaboracionizmi si armik i demokracisë"

Ky Forum, i cili u organizua më 8 nëntor 2011 u përqëndrua në disa nga faktet e reja dhe vlerësimet e librit "Lufta Italo-Greke: Diktatorë dhe Kuislingë" të Akademikut Prof. Dr. Arben Puto, botuar nga UMSH Press dhe TOENA. Në Forum morrën pjesë personalitete të shquara të fushës akademike, studiues, dhe studentë.

The Mediterranean integration in the European integration context: The role of higher education in the integration process of Albania, into the European Union-EMUNI REGIONAL DAY

Ky Forum u mbajt më 16 dhjetor 2011. I ftuar nderi dhe spiker kryesor ishte President i EMUNI University. Forumi trajtoi çështjet e integrimit evro-mesdhetar të Shqipërisë, historinë e zhvillimeve Euro-Mesdhetare, rolin e arsimit të lartë në këto zhvillime, bashkëpunimet universitare evro-mesdhetare, bashkëpunimet kërkimore-

shkencore evro-mesdhetare, oportunitetet e zhvillimit, edukimit dhe të integrimit në Mesdhe, oportunitetet e EMUNI me universitetet partnere në rreth 40 vende të rajonit Euro-Mesdhetar.

Pjesëmarrje në projekte shkencore ndërkombëtare Pedagogët e brendshëm, të jashtëm dhe bashkëpunëtorët e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë gjatë periudhës shtator 2009- dhjetor 2011 kanë marrë pjesë në tre projekte shkencore ndërkombëtare, në bashkëpunim me kërkues dhe pedagogë italianë dhe grekë:

Projekti "Migrimi dhe integrimi i shqiptarëve në rajonin Puglie", financuar nga Osservatorio Provinciale sull'Immigrazione, pranë Univesitetit të Salentos, Itali.

Projekti "Reforma ligjore në BE dhe vendet candidate", financuar nga Universiteti John Hopkins, SHBA, dhe Universiteti i Bolonjes, Itali.

Projekti "Integrimi Evro-mesdhetar dhe evro-aziatik në kontekstin e integrimeve evropiane", financuar nga Rrjeti EURAS dhe Rrjeti EMUNI.





Marrëveshjet

(Universitetet partnere, biznesi, institucionet shtetërore)

Bashkëpunimi nëpërmjet Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë me institucionet e tjera ka qenë i mundur si në nivel lokal, kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Përsa i përket bashkëpunimit kombëtar UMSH ka realizuar shumë ndër të cilat mund të përmendim Marrëveshjet e Bashkëpunimi me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin e Gjirokastrës me Avokatin e Popullit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen për të dhënat personale; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit; Instituti i Statistikave të Shqipërisë; Instituti Shqiptar i Audituesve të Brendshëm; Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Akademia Diplomatike e Londrës, etj. Bashkëpunimi ndërkombëtar me institucionet homologe është një ndër aspektet kryesore të punës të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Për këtë lloj bashkëpunimi mund të përmendim "Memorandumin e Mirëkuptimit" të nënshkruar ndërmjet Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë dhe Akademisë Diplomatike të Londrës, Marrëveshjet e Bashkëpunimit me University

Zhvillimi i procesit akademik universitar është i lidhur në mënyrë të veçantë me zgjerimin dhe konkretizimin e marrëveshjeve dhe memorandumëve të bashkëpunimit në nivel ndërkombëtar me institucione arsimore apo kërkimore shkencore prestigjioze.

of Bari "Aldo Moro"; Sigmund Freud University of Paris; CEMAS Sapienza; Mediterranean University of Podgorica; University of East Anglia(UEA); International University of Struga; Iliria College (Pristine); EBS Eaton Business School, UK; State University of Library studies and information technologies; University of Niš; Universita Della Calabria; University of Social Sciences Lodz; University of Social Sciences Lodz; Dimitrie Cantemir Christian university- Romania; Universitetin e Tuzlës në Bosnjë-Hercegovinë; LUM Jean Monnet University, Casamassima (BA), Itali; Universitetin e Qipros; Kolegjin Universitar "Biznesi" me seli në Prishtinë etj. Pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare: Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është anëtar i EMUN-it, rrjetit të universiteteve të Mesdheut dhe EURAS. Si anëtar i këtyre rrjeteve, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është në marrëdhënie dhe

bashkëpunim të vazhdueshëm në formë projektesh të përbashkëta dhe shkëmbimi akademik me universitetet anëtare të këtij rrjeti. Në kuadër të pjesëmarrjes si drejtues apo partner, në mbi 10 projekte të financuara me fonde të BE-së dhe fonde të tjera ndërkombëtare, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është në marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me organizata homologe dhe të tjera si: Universita Politecnico di Bari; University of Bologna; University of Patras,; Bulgarian School of Politics; Economic Faculty of Rijeka; Regione del Veneto; Confindustria Veneto SIAV S.p.A.; Confindustria Bari e Barletta-Andria-Trani; Regione Puglia; Chamber of Ahaia Prefecture; Municipality of Primorsko-goranska, Center For Change Management, etj.

Në shërbim të zhvillimit të praktikës profesionale për studentët, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka ndërtuar marrëdhënie




bashkëpunimi efektiv me përfaqësues dhe organizata të ndryshme të sektorit privat në Shqipëri dhe vende të rajonit, ndër të cilat mund të përmendim, bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë të Tiranës; Aleancën e Biznesit të Kosovës; Shoqatën e Ndërtuesve të Shqipërisë; Shoqatën e Bankave të Shqipërisë; Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë; Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësimit etj. Të shumta dhe të efektshme janë lidhjet që Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka krijuar dhe realizuar me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës ku mund të përmendim bashkëpunimin me: Dhomën e Tregëtisë dhe e Industrisë, Tiranë; B&T Sistem; Institutin e Modelimeve në Biznes; Dhomën Kombëtare të Avokatëve; BNT Elektronics; A&D Business Consulting etj. Në qendër të këtyre marrëveshjeve është bashkëpunimi në fushat me interes të ndërsjelltë, realizimi i praktikave mësimore të studentëve si dhe punësimi i tyre.

Diplomimet ndër vite



WWW.UMSH.EDU.AL



Studentët ALUMNI

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka krijuar traditën e organizimit të Forumit të Mesdheut, e cila zhvillohet në mjediset e Universitetit Mesdhetar. Ky Forum zhvillohet periodikisht njëherë në tre muaj. Në këtë kontekst janë zhvilluar Forumet me tematikat e mëposhtëme:



Kostandin Titka

I diplomuar ekselent në vitin 2015-2016 për Shkenca ekonomike. Vazhdon studimet Master në Gjermani.



Giola Cami

E diplomuar ekselente në vitin 2013-2014 për Shkenca Politike. Aktualisht vazhdon studimet e Doktoraturës.



Klea Lleshi

E diplomuar ekselente në vitin 2015-2016 për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci.



Laert Kika

E diplomuar ekselente në vitin 2014-2015 për Finance Banke.



Elona Shahini

E diplomuar ekselente në vitin 2012-2013 për Finance Banke.



Elona Dhimolea

E diplomuar ekselente në vitin 2013-2014 për Finance Banke.

Andi Teqja, Msc Finance Banke, 2013-2014
 Brunilda Çoti, Bsc Administratë Publike, 2013-2014
 Erdet Lalaj, Msc Finance Banke, 2013-2014
 Juljana Bilbilaj, Msc.Marrëdhënie Nderkombetare, 2017-2018
 Alma Sinanaj, MP-MB Menaxhim Arsimi, 2012-2013
 Amisa Tusha, Bsc Informatike Biznesi, 2017-2018
 Arif Billa, Bsc Finance Banke dhe Kontabilitet, 2013-2014
 Dea Bashkurti, Msc.E Drejte Publike, 2017-2018
 Devis Thaçi, MP-MB Menaxhim Shendetit, 2012-2013
 Dorina Canaj, Bsc Juridik, 2015-2016
 Elsaida Mustafa, Msc.Marrëdhënie Nderkombetare, 2017-2018
 Emanuela Baba, Bsc Juridik, 2017-2018
 Hesjona Avdiko, MP-MB Menaxhim Shendetit, 2012-2013
 Klea Panajot, Bsc Informatike Biznesi, 2017-2018
 Kristiana Sterjo, Bsc Juridik, 2016-2017
 Kristiana Mera, Bsc Juridik, 2017-2018
 Kristina Caca, Bsc Juridik, 2017-2018
 Malvina Murrja, Bsc Finance Banke dhe Kontabilitet, 2014-2015
 Manjola Bedaj, Bsc Juridik, 2017-2018
 Ota Nikoçi, Bsc Informatike Biznesi, 2016-2017
 Sonila Rapaj, Bsc. Shkenca Politike, 2011-2012

nevojë.

Gjatë viteve të studimit studentët tanë bëhen pjesë e aktiviteteve ekstrakurrikulare si dhe të aktiviteteve studentore me karakter kulturor dhe sportiv. Aktivitete ekstrakurrikulare si shkolla verore dhe konferenca studentore të organizuara nga Universiteti ynë në bashkëpunim me Universitete brenda dhe jashtë vendit por edhe organizime studentore si ekipi i futbollit dhe basketbollit, grupi studentor i kinemasë politike, janë disa nga shembujt më të suksesshëm.

Jeta studentore

Mesdhetari u ofron studentëve një ambient në të cilin përveç aftësive profesionale të formojnë dhe të kultivojnë edhe ndjenjat dhe vlerat komunitare dhe qytetare. Studentët tanë janë përherë të pranishëm në aktivitetet me karakter humanitar dhe social të organizuar nga shkolla në bashkëpunim me institucione të ndryshme si dhe kanë ndërmarrë shpesh herë fushata sensibilizuese si dhe mbledhje fondesh për bashkëqytetarët tanë në



KU E SHOHIM UNIVERSITETIN MESDHETAR TË SHQIPËRISË

Misioni dhe objektivi kryesor i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, si një institucion bashkëkohor elitari i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, edhe në vitet që do të vijnë, vijon të jetë pajisja e gjeneratave të reja me dije të nivelit të lartë, me aftësi për tu përshtatur në tregun e punës, me interesa thelbësore për të vijuar studimin dhe pasurimin e materialit shkencor në vijimësi dhe pa ndërpreje, nëpërmjet instrumentave mësimorë, didaktikë dhe kërkimor-shkencorë, por edhe atyre praktikë.

Këtë mision, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë do të vijojë ta realizojë me studentin në qendër, duke nxitur dhe inkurajuar kërkesën për cilësi tek studentët e të gjitha niveleve, të vullnetit për të përfunduar mendimin e përparuar shkencor deri në nivelet e elitizimit intelektual duke siguruar kështu përgatitjen e specialistëve të rinj, të spikatur, me përkushtim qytetar dhe njerëzor për zhvillimin e shoqërisë dhe konsolidimin e vlerave sociale dhe humane si dhe rritjes së konkurrueshmërisë në nivel lokal e global.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë do të vijojë të inkurajojë kërkimin shkencor si dhe debatin shkencor në disa drejtime të cilat i ka identifikuar si të rëndësishme dhe prioritare për zhvillimin e mëtejshëm të vetë institucioni, por edhe vendit. Kjo do të arrihet nëpërmjet sigurimit të burimeve të financimit për kërkimin shkencor brenda dhe jashtë vendit, në të gjitha nivelet, përdorimit të strukturave të organizuara që garantojnë lirinë e kërkimit shkencor, garantimit të të gjithë infrastrukturës materiale dhe njerëzore për shkëmbime të karakterit kërkimor dhe shkencor me institucione homologe të kërkimit brenda dhe jashtë vendit.

Më e rëndësishmja mbetet nxitja dhe mbështetja në vazhdimësi e realizimit të kërkimit shkencor me interes publik në shërbim të institucioneve publike dhe private duke u konsoliduar si një qendër konkurruese kërkimore-

Sfida & objektiva



**Eja dhe bëji vitet
e tua të studimit
në UMSH një
eksperiencë
Unike**



shkencore e cila kontribuon në debatin shkencor e profesional, për hartimin e strategjive sipas stave të zhvillimit të vendit, si dhe rritjen e kontributit nëpërmjet rekomandimeve në politikë-bërje dhe vendim-marrje për zhvillim në nivel vendi, por dhe shndërrimin e UMSH një qendër kërkimore-shkencore rajonale dhe pikë kryesore e referimit të politikave të bashkëpunimit dhe zhvillimit të vendit, dhe jo vetëm, në ekspertizën për zhvillimet rajonale, Euromesdhetare, evropiane dhe globale.

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i jep një rëndësi të veçantë përfshirjes në projekte ndërkombëtare dhe rrjete (netëorks) të ndryshme Universitare me qëllim bashkëpunimin më të ngushtë

në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, rritjen e nivelit të ekspertizës si dhe lehtësimin e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik. Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare dhe rrjete universitare ndërkombëtare, i ka shërbyer dhe do t'i shërbejë si një eksperiencë shumë pozitive jo vetëm për diskutimin e çështjeve që lidhen drejtpërdrejt me arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe marrjen e vendimeve kolektive për to, por kryesisht për përfshirjen si partnerë në atë që është në thelb ndërkombëtarizimi i studimeve universitare pra organizmi i programeve të përbashkëta të studimit në të gjitha ciklet e studimit.





KONTAKT:

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

Adresa: Blv. Gjergj Fishta, Nr.52,

Kodi Postar: 1023, Tiranë

Tel: +355 (4) 2421774

Cel: +355 68 50 47301

Email: info@umsh.edu.al

Rrjetet tona sociale

Fb: [Universiteti Mesdhetar i Shqiperise](#)

In: [@universitetimesdhetar](#)